



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHËTËRËTOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

### Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Komuna e Haraçinës

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (637) për vitin 2021

### Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, ndërsa aktivitetet dhe transaksionet e reflektuara janë në pajtim me rregullativën ligjore.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- kryerja e punimeve ndërtimore - ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugëve dhe rrugicave janë pa miratim për ndërtim dhe projekt bazë, dhe vënia në përdorim e ndërtimeve është kryer pa procesverbal të pranimit;
- mos evidentimi i pronës së patundshmërisë në pronësi të komunës;
- nuk është siguruar dokumentacioni shoqërues përkatës për një pjesë të shpenzimeve të evidentuara.

### Mendimi i dhënë \*:



Shprehëm mendim të pavolitshëm për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare, llogaria e buxhetit themelor (637) për vitin 2021 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

/

### Rekomandimet kyçe:

Kryetari i komunës të ndërmer masa dhe aktivitete për:

- Sigurimin e miratimeve për ndërtimet, para fillimit të aktiviteteve për ndërtimin e objekteve në të cilat investitor është komuna dhe planifikimi i ndërtimeve dhe zbatimi i tyre të kryet në bazë të projektit bazë në pajtim me Ligjin për ndërtim;
- toka dhe objektet e ndërtuara me të cilat disponon komuna të evidentohen në evidencën e kontabilitetit të komunës;
- ndryshimet në librat afariste të jenë në bazë të dokumentacionit të plot dhe të besueshëm të kontabilitetit.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje për Draft-Raportin nr. 133/2 nga 25.01.2023 të llogarisë së buxhetit themelor (637) për vitin 2021.

### Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

/



pozitive,



me rezervë



të pavolitshëm



të përmbajtur